



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë

Numër 21

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë dhe Pritjet për Inflacionin

(TM3 2024 dhe pritjet për TM4 2024)

Numër 21

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Analizave Ekonomike
dhe i Stabilitetit Financiar

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: +383 38 222 055

Fax: +383 38 243 763

Faqja e internetitwww.bqk-kos.org**Adresa elektronike**

economic.analysis@bqk-kos.org

Përmbajtja

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë (AKBK) -----	4
Hyrje -----	4
Përmbledhja e rezultateve -----	4
Kutia 1. Metodologjia -----	7
Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi -----	7
Kreditë ndaj ndërmarrjeve -----	8
Standardet kreditore -----	8
Kushtet dhe rregullat-----	8
Kërkesa për kredi-----	9
Kreditë ndaj ekonomive familjare -----	10
Standardet kreditore -----	10
Kushtet dhe rregullat-----	11
Kërkesa për kredi-----	11
Financimi -----	12
Rezultatet e pyetjeve të fokusuara -----	10
Pritjet për Inflacionin -----	14
Metodologjia -----	14
Përmbledhja e rezultateve -----	15

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë (AKBK)

Hyrje¹

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve analitike për një vlerësim sa më të mirë të dinamikave të kreditimit në Kosovë dhe pritjeve për zhvillimet në nivelin e çmimeve, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka dizajnuar dhe realizuar një anketë me bankat komerciale që operojnë në tregun bankar në Kosovë. Raporti që do të analizoj rezultatet e këtij anketimi, do të publikohet në frekuencë tremujore në web-faqen e BQK-së, me qëllim që të ofrojë një pasqyrë më të gjerë rreth perceptimit të rrezikut të bankave dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, si dhe, sjelljes së ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve kundrejt dinamikave në kreditim, si pasojë. Ky raport evidenton sjelljen kreditore për periudhën e tremujorit të tretë të vitit 2024, dhe pritjet e bankave për dinamikat në kreditim për tremujorin e katërt të vitit 2024.

Përveç pyetjeve standarde, kjo anketë është plotësuar me katër pyetje shtesë në përpjekje për të identifikuar rreziqet eminente në sektorin bankar, si dhe zberthimin e ofertës dhe kërkesës kreditore për ndërmarrjet sipas sektorëve ekonomik.

Përmbledhja e rezultateve²

Stoku i kredive në fund të shtatorit 2024 arriti vlerën në 5.51 miliardë euro, duke vazhduar trendin e rritjes dyshifrore për të katërtin vit me radhë. Në të dy segmentet u shënua rritje vjetore e kreditimit, megjithëse rritja rezultoi të ketë qenë më e theksuar për ekonomitë familjare kundrejt ndërmarrjeve. Ecuria e kredive të reja të lëshuara gjatë periudhës janar-shtator 2024 në përgjithësi ndoqi trendin e gjithsej kreditimit - sipas segmenteve specifike, kishte rritje të theksuar për ekonomitë familjare ndërsa ngadalësim për ndërmarrjet.

Rezultatet e anketës së tremujorit të tretë të vitit 2024 të realizuar me bankat sugjerojnë se dinamikat në kreditim u ndikuan kryesisht nga kërkesa kreditore, ndërkohë që oferta kreditore kishte lëvizje marginale. Edhe për tremujorin e katërt të vitit 2024, bankat presin që shtytësi i aktivitetit kreditor të vazhdoj të jetë kërkesa kreditore, por për dallim nga tremujori aktual, segmenti i ekonomive familjare pritet të ketë peshën më të madhe në përcaktim të dinamikës së përgjithshme. Sa i përket ofertës kreditore, bankat deklaruan që do të aplikojnë standarde kreditore pothuajse të pandryshuara për të dy segmentet.

Për segmentin e ndërmarrjeve, rritja e kreditimit, sipas rezultateve të anketës, rezultoi të jetë mbështetur kryesisht nga kërkesa, ndërkohë që oferta kreditore ishte pothuajse e pandryshuar gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024. Ngjashëm me ecurinë e përgjithshme të këtij segmenti, bankat aplikuan standarde kreditore pothuajse të pandryshuara në këtë tremujor si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha (tabela 1). Norma në rënie e Euribor, mbështetja nga FKGK dhe pozita e likuiditetit në sektor ndikuan pozitivisht në ofertën kreditore të sektorit bankar. Faktorët që rezultojnë të kenë ndikuar negativisht standardet kreditore kishin të bëjnë me tolerancën më të ulët të sektorit për rrezikun që bartë segmenti i ndërmarrjeve dhe cilësia kreditore - rritja e kredive me probleme. Për tremujorin e fundit të vitit 2024, bankat presin që standardet kreditore të mbesin të ngjashme me ato të aplikuara përgjatë tremujorit të tretë të vitit 2024 si për NVM-të dhe ndërmarrjet e mëdha (tabela 1). Faktorët të cilët pritet të kenë potencial lehtësues në standardet kreditore të

¹ Për informata më të detajuara rreth qëllimit dhe historikut të anketës së kreditimit bankar në BQK, shikoni publikimin "Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit" Nr. 1.

² Pyetësori dhe seria kohore e rezultateve të AKBK-së janë në dispozicion në faqen e internetit të BQK-së, nën vegzën e Anketës së Kreditimit Bankar.

aplikuara nga bankat në tremujorin e ardhshëm po ashtu kanë të bëjnë me normën në rënie të Euribor, përkrahjen nga FKGK, pozitën e likuiditetit, kurse për dallim nga tremujori paraprak edhe konkurrenca prej sektorit jobankar pritet të ketë efekt lehtësues. Në anën tjetër, perspektivën e tregut vendor në tremujorin vijues, tolerancën më të ulët të rrezikut për ndërmarrjet dhe cilësia kreditor - rritja e kredive me probleme janë ndër faktorët kryesor mund të kenë potencial shtrëngues në standardet kreditore të aplikuar nga bankat.

Kushtet dhe rregullat e aplikuar nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet në përgjithësi mbetën kryesisht të pandryshuara për të dy segmentet e ndërmarrjeve. Mirëpo, për ndërmarrjet e mëdha u aplikua lehtësim i standardeve deri në një masë në madhësinë e kredisë së lejuar. Sa i përket pagesave tjera përveç normës së interesit (kryesisht tarifave dhe komisioneve të ndryshme), mbetën të pandryshuara si për NVM-të dhe ndërmarrjet e mëdha. Në anën tjetër, kushtet dhe rregullat e aplikuar u ndikuan pozitivisht nga mbështetja nga FKGK, presioni nga konkurrenca ndërbankare dhe pozita e likuiditetit të bankave. Edhe në tremujorin e fundit të vitit 2024, kushtet dhe rregullat e aplikuar nga bankat në përgjithësi pritet të mbeten kryesisht të ngjashme me tremujorin e tretë, me përjashtim të kërkesave për kolateral që pritet të jenë më të lehtësuara për NVM-të, dhe madhësia e kredisë që pritet të jetë më e lehtësuar për ndërmarrjet e mëdha (rritje të vlerës së kredisë).

Sa i përket kërkesës për kredi nga segmenti i ndërmarrjeve, tremujori i tretë historikisht karakterizohet me kërkesë më të dobët sa tremujori paraprak dhe ai vijues. Mirëpo, për TM3 2024, bankat deklaruan kërkesë të lartë kreditore nga ndërmarrjet, si nga ndërmarrjet e mëdha dhe veçanërisht NVM-të. Në përgjithësi, rritja e kërkesës për kredi, sipas deklarimeve të bankave, u nxit kryesisht nga rritja e kërkesës për financim të inventarit dhe kapitalit punues dhe investimeve fikse. Në tremujorin vijues, kërkesa për kredi nga NVM-të pritet të vazhdoj të jetë e lartë, por dukshëm më të ulët krahasuar me atë të raportuar në TM3 2024. Edhe në tremujorin vijues, rritja e kërkesës për kredi pritet ti atribuohet kryesisht kërkesës për financim të inventarit dhe kapitalit punës si dhe investimeve fikse.

Aktiviteti kreditues ndaj ekonomive familjare ka vazhduar të zgjerohet me ritëm të përshpejtuar gjatë vitit 2024, mbështetur kryesisht nga kërkesa më e lartë kreditore, pasi që oferta kreditore mbeti e pandryshuar sipas deklarimeve të bankave në AKB edhe për TM3 2024. Standardet kreditore të aplikuar nga bankat për ekonomitë familjare mbetën kryesisht të pandryshuara në TM3 2024, si për kreditë konsumuese dhe ato për blerje të shtëpive. Për më tepër, edhe për tremujorin e fundit të vitit 2024, standardet kreditore pritet të mbesin të pandryshuara për të dy segmentet e ekonomive familjare (tabela 1). Faktorët që ndikuan në lehtësim të standardeve kreditore përgjatë TM3 2024 ishin konkurrenca ndërbankare, pozita e likuiditetit të bankave, rritja e besueshmërisë ndaj kredimarrësve, perspektiva pozitive në tregun vendor dhe bankave vendore për këtë segment të ekonomisë. Mirëpo, u neutralizuan nga faktorët shtrëngues në standardet kreditore për segmentin e ekonomive familjare, siç janë cilësia kreditore që ka të bëjë me rritjen e vlerës së kredive me probleme dhe qasja në gjithsej financim për bankat vendore. Në tremujorin vijues, faktori që pritet të ketë ndikimin në shtrëngim të standardeve kreditore janë rritja potenciale e kredive me probleme, ndërkohë që pozita e mirë e likuiditetit, qasja më e lehtë në financim tek bankat amë (bankat e huaja që operojnë në vend) dhe konkurrenca në sektor pritet të kenë efekt lehtësues.

Në përgjithësi, kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare mbetën të pandryshuara gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024. Rezultatet e gjeneruara nga përgjigjet e bankave reflektojnë ndryshim, përkatësisht lehtësim deri në një masë vetëm në madhësinë e kredisë (shumën mesatare të kredisë) për kreditë për blerje të shtëpive, përderisa për kreditë konsumuese mbetën të pandryshuara. Konkurrenca brenda sektorit, pozita e mirë me likuiditet dhe besueshmëria ndaj kredimarrësve ishin faktorët që ndikuan në lehtësim të kushteve dhe rregullave për blerje të shtëpive, përkatësisht në rritje të shumës mesatare të kredisë. Për tremujorin e katërt të vitit 2024, bankat presin kushte dhe rregulla përgjithësisht të pandryshuara për kreditë e reja, përjashtuar lehtësim në

normën e interesit për kreditë për blerje të shtëpive, kurse për kreditë konsumuese, ngjashëm me tremujorin aktual, nuk pritet të ketë ndryshime në kushtet dhe rregullat për marrje të kredive.

Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare ka shënuar rritje përgjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, por më e ulët se në tremujorin paraprak; me kërkesë të rritur në nivel të ngjashëm si për kreditë konsumuese dhe ato për blerje të shtëpive. Sipas bankave, nevoja për financim të shpenzimeve të konsumit dhe perspektiva e mirë në tregun e patundshmërive kishin ndikimin më të lartë në rritjen e deklaruar të kërkesës për kredi për të dy segmentet e ekonomive familjare. Për tremujorin vijues, bankat presin rritje më të lartë të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, e që do të jetë më e theksuar për kreditë konsumuese (tabela 1). Kërkesa për kredi në tremujorin vijues pritet po ashtu të nxitet nga perspektiva pozitive në tregun e patundshmërive dhe kërkesa në rritje për kreditë konsumuese.

Tabela 1. Vlerësimi i bankave për ndryshimet në ofertën dhe kërkesën kreditore

	Oferta (Standardet kreditore)		Kërkesa	
	TM3 2024	TM4 2024 (pritjet)	TM3 2024	TM4 2024 (pritjet)
Ndërmarrjet	➔	➔	⬆️	⬆️
NVM	➔	➔	⬆️	⬆️
Ndërmarrjet e mëdha	➔	➔	⬆️	➔
Ekonomitë familjare	➔	➔	➔	⬆️
Kredi për blerjen e shtëpive	➔	➔	➔	➔
Kredi konsumuese	➔	➔	➔	⬆️

⬆️ Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv mbi 0.20)

➔ Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv nën 0.20)

➔ Kryesisht pandryshime (indeks pozitiv/negativ deri 0.05)

➔ Shtërngim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ nën 0.20)

⬇️ Shtërngim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ mbi 0.20)

Burimi: BQK.

Në tremujorin e tretë të vitit 2024 bankat aplikuan qasje dukshëm më lehtësuese në vlerësimin e aplikacioneve të reja për ndërmarrjet - veçanërisht për ndërmarrjet e vogla, kurse për ekonomitë familjare në përgjithësi mbeti e pandryshuar, me lehtësim deri në një masë për kreditë për blerje të shtëpive. Lehtësim më të theksuar kishte në shqyrtim të aplikacioneve të reja për kreditë me maturitet afatshkurtër për segmentin e ndërmarrjeve, kurse për ekonomitë familjare, ndryshime marginale pozitive në kreditë me maturitet afatgjatë si rezultat i lehtësirave në kreditë për blerje të shtëpive. Në tremujorin e fundit të vitit 2024, qasja e bankave në vlerësim të aplikacioneve të reja për kredi pritet të jetë më e lehtësuar për ekonomitë familjare (konsumuese dhe për blerje të shtëpive) ndërsa për ndërmarrjet, pritet të jetë e ngjashme me tremujorin aktual, si për NVM-të dhe ndërmarrjet e mëdha.

Qasja në financim në tremujorin e tretë të vitit 2024 rezulton të jetë më e lartë krahasuar me tremujorin paraprak, duke ndjekur trendin historik, e që mund të jetë rezultat i efektit të diasporës (rritjes së remitencave dhe eksportit të shërbimeve vendore), si dhe ciklit të biznesit. Bankat deklaruan rritje të lartë të financimit nga ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare, me këto të fundit në nivel lehtësisht më të ulët se në tremujorin paraprak. Sa i përket maturitetit, bankat deklaruan rritje më të ngadalësuar të burimeve të financimit afatshkurtër, kurse rritje më të lartë të financimit afatgjatë (mbi një vit). Gjatë tremujorit të ardhshëm, bankat presin rritje të ngjashme të financimit

me tremujorin aktual, por që do të zhvendoset fokusi, nga financimi i ndërmarrjeve tek financimi prej depozitave të ekonomive familjare, të cilat do të kenë kontributin më të lartë në gjithsej financimin e sektorit bankar. Për më tepër, për tremujorin vijues pritet rritje më e lartë e financimit afatgjatë, kundrejt rritjes më të ulët të financimit afatshkurtër.

Kutia 1. Metodologjia

Pyetësi i Anketës së Kreditimit Bankar në Kosovë

Pyetësi i AKBK është i bazuar në forma të standardizuara të pyetësorëve të përdorur nga Bankat Qendrore të vendeve të eurozonës dhe më gjerë. Megjithatë, pyetësi i BQK për AKBK është modifikuar dhe përshtatur që në mënyrën më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse të paraqet zhvillimet e kreditimit në sektorin bankar në Kosovë.

Pyetësi i AKBK përbëhet nga 19 pyetje, të cilat mbulojnë ndryshimet në ofertën dhe kërkesën për kredi, faktorët që kontribuojnë në këto ndryshime si dhe qasjen në financim të sektorit bankar, në baza tre mujore. Pyetjet mbi kreditimin bankar fokusohen në dy kategori kryesore: (i) kreditë ndaj ndërmarrjeve, dhe (ii) kreditë ndaj ekonomive familjare. Për më tepër, kreditë ndaj ndërmarrjeve nën-kategorizohen në kreditë ndaj NVM-ve dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve të mëdha, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare nën-kategorizohen në kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë konsumuese. Për të gjitha kategoritë e lartpërmendura, ndryshimet në ofertën kreditore përcaktohen nga standardet kreditore të aplikuara gjatë aprovimit të kredive, kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja, norma e aprovimit të kredive, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimet e tyre. Ndërsa, ndryshimet në kërkesën për kredi përcaktohen nga kërkesa për kredi (numri i aplikacioneve për kredi), cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi, si dhe faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi. Pyetjet e anketës kryesisht janë të formuluar për ndryshimet gjatë tre muajve paraprak dhe pritet për tre muajt e ardhshëm. Gjithashtu, pyetjet mbulojnë kreditë edhe në aspekt të maturimit të tyre dhe valutës në të cilën lëshohen.

Përveç pyetjeve standarde, pyetësi i AKBK mund të përmbajë edhe pyetje shtesë mbi çështje specifike me interes për shpjegimin e zhvillimeve në sektorin bankar. Përderisa pyetjet standarde mbulojnë një periudhë tre-mujore, pyetjet shtesë mund t'i referohen ndryshimeve gjatë një periudhe kohore më të gjatë. Në anketim marrin pjesë dhjetë nga dymbëdhjetë bankat që operojnë në Kosovë. Rrjedhimisht, bankat pjesëmarrëse përfaqësojnë tregun e përgjithshëm bankar dhe sigurojnë një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se përfaqësojnë rreth 98 përqind të aseteve të gjithsej sektorit bankar dhe 99.1 përqind të gjithsej kreditimit në sektorin bankar.

Pjesëmarrësve të anketës u kërkohet të tregojnë në mënyrë cilësore forcën e çdo shtrëngimi ose lehtësimi apo forcën e çdo ulje ose rritje, duke raportuar ndryshimet përmes pesë shkallëve si: (i) shtrënguar / ulur në mënyrë të konsiderueshme, (ii) shtrënguar / ulur në një masë, (iii) e pandryshuar, (iv) lehtësuar / rritur në një masë ose (v) lehtësuar / rritur në mënyrë të konsiderueshme.

Gjenerimi i rezultateve të anketës së kreditimit bankar

Kuantifikimi i përgjigjeve të marra nga bankat individuale dhe agregimi i tyre për të paraqitur ndryshimet në nivel sektori arrihet përmes gjenerimit të një indeksi. Ky indeks gjenerohet për çdo kategori e nën-kategori të secilës pyetje, duke dhënë në këtë mënyrë një njësi kuantifikuese për përgjigjet e marra në nivel të sektorit. Fillimisht, përgjigjeve u përcaktohet një vlerë në bazë të forcës së ndryshimeve, konkretisht përgjigjeve ku bankat kanë deklaruar shtrëngim/ulje të konsiderueshme u përcaktohet vlera - 1, vlerë dyfish më e madhe se sa ajo e përcaktuar për përgjigjet kur bankat deklarojnë shtrëngim / ulje deri në një masë (vlerë prej -0.5). Ngjashëm, përgjigjet kur kemi lehtësim/rritje të konsiderueshme kanë vlerë 1, përderisa ato me lehtësim/rritje deri në një masë u përcaktohet vlera 0.5. Rezultatet po ashtu janë të peshuara në bazë të peshës që secila prej bankave ka në gjithsej kreditimin e sektorit bankar. Përfundimisht, pesha e secilës bankë sipas pjesëmarrjes në tregun e kredive shumëzohet me vlerën e përcaktuar në bazë të intensitetit të përgjigjes së dhënë, duke fituar indeksin në fjalë. Më tutje, agregimi i indeksit në nivel sektori bëhet përmes shumës së indekseve të fituara për secilën bankë. Vlerat e indeksit janë në mes të -1 dhe 1, ku vlerat pozitive të indeksit paraqesin lehtësim, rritje apo kontribut pozitiv dhe në kontrast vlerat negative paraqesin shtrëngim, rënie apo kontribut negativ.


Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi

Kreditë ndaj ndërmarrjeve

Standardet kreditore

Në tremujorin e tretë të vitit 2024 standardet kreditore të aplikuara nga bankat (politikat kreditore) mbetën pothuajse të pandryshuara nga tremujori i kaluar, e që janë në linjë me raportimet e bankave në TM2 2024. Oferta kreditore në TM3 2024 kishte ndryshime marginale (të papërfillshme) në kahun negativ (grafiku 1).

Grafik 1. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuon




Në kuadër të kategorive të ndërmarrjeve, bankat deklaruan standarde kreditore të shtrënguara marginalisht si për ndërmarrjet e mëdha dhe NVM-të. Faktorët kryesor që ndikuan pozitivisht në standardet kreditore ishin norma në rënie e Euribor, mbështetja nga FKGK dhe pozicioni me likuiditetet e bankave. Kurse, faktorët të cilët ndikua negativisht në standardet kreditore ishin perspektiva e tregut vendor në këtë tremujor, zvogëlim i tolerancës për të ndërmarr rrezik, që u ndikua nga rritja e vlerës së kredive me probleme. Faktorët tjerë ndikues në standardet kreditore kishin lëvizje marginale në të dy kahjet pa ndikim të theksuar dhe kanë të bëjnë me: perspektivën e bankave vendore, qasjes në financim nga bankat vendore dhe presioni nga konkurrenca.

Standardet kreditore në përgjithësi, në tremujorin e fundit të vitit 2024 pritet të mbesin të ngjashme me ato të aplikuara përgjatë tremujorit aktual (TM3 2023) si për ndërmarrjet e mëdha dhe NVM-të. Norma në rënie e Euribor, përkrahja nga FKGK dhe pozicioni me likuiditetet e bankave pritet të kontribuojnë pozitivisht në lehtësim të standardeve kreditore. Kurse, faktorët të cilët pritet të kenë ndikim potencial negativ në standardet kreditore për ndërmarrjet kanë të bëjnë me zvogëlimin e tolerancës për të ndërmarr rrezik, e që është ndikuar edhe nga rritja e vlerës së kredive me probleme dhe perspektiva e tregjeve globale . Faktorët tjerë pritet që të kenë lëvizje marginale pozitive/negative në standardet kreditore, siç janë perspektiva e bankave vendore, qasja në financim nga bankat vendore dhe konkurrenca.

Kushtet dhe rregullat

Në linjë me standardet kreditore, edhe kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive (kushtet e specifikuar për një kontratë të caktuar për kredi), në tremujorin e tretë të vitit 2024, mbetën kryesisht të pandryshuara për të dy segmentet e ndërmarrjeve (grafiku 2). Konkretisht, lehtësim deri në një masë u aplikua në madhësinë e kredisë së lejuar për ndërmarrjet e mëdha. Lehtësim marginal kishte në kërkesat për kolateral si për ndërmarrjet e mëdha dhe NVM-të. Kurse, sa i përket pagesave tjera përveç normës së interesit (kryesisht tarifave dhe komisioneve të ndryshme), mbetën të pandryshuara si për ndërmarrjet e mëdha dhe NVM-të. Kushtet dhe rregullat e aplikuara u ndikuan pozitivisht nga mbështetja nga FKGK-ja, presioni nga konkurrenca ndërbankare dhe pozita me likuiditet. Në anën tjetër, kushtet dhe rregullat e aplikuara u ndikuan negativisht prej kufizimeve në qasje në kapital nga bankat vendore, cilësisë kreditore dhe perspektivës në tregjet globale.

Grafik 2. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet



Edhe në tremujorin e fundit të vitit 2024, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat në përgjithësi pritet të mbeten kryesisht të ngjashme me tremujorin aktual, me përjashtim të kërkesave për kolateral, që pritet të jenë dukshëm më të lehtësuara për NVM-të. Faktorët që priten të ndikojnë pozitivisht në kushtet dhe rregullat e kreditimit kanë të bëjnë me konkurrencën bankare, mbështetjen prej FKGK-së dhe norma në rënie e Euribor-it. Kurse, perspektiva e tregjeve globale mund të ndikojë negativisht kushtet dhe rregullat e kreditimit gjatë tremujorit të ardhshëm.

Kërkesa për kredi


Lidhur me kërkesën për kredi nga segmenti i ndërmarrjeve, tremujori i tretë i vitit historikisht është më i dobët se tremujori paraprak dhe ai vijues. Por, në këtë tremujor – TM3 2024, bankat deklaruan kërkesë të lartë për kredi, si për ndërmarrjet e mëdha dhe në veçanti për NVM-të. Mirëpo, në anketën e realizuar në tremujorin e kaluar (TM2 2024), bankat kishin parashikuar kërkesë më të ulët për kredi për tremujorin aktual (TM3 2024) (grafiku 3).

Sipas rezultateve të anketës, në përgjithësi, rritja e kërkesës për kredi u nxit kryesisht nga rritja e kërkesës për financim të inventarit dhe kapitalit punues dhe investimeve fikse, por me intensitet më të ulët. Cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ndërmarrjet ka shënuar përmirësim në TM3 2024 krahasuar me tremujorin paraprak. Përkatesisht, kishte përmirësim të cilësisë së aplikacioneve të dorëzuara nga NVM-të, si për kërkesat për kreditë afatshkurtra dhe ato afatgjata, përderisa cilësia e aplikacioneve nga ndërmarrjet e mëdha mbeti e pandryshuar.

Sipas anketës, gjatë TM3 2024 niveli i kredive jo-performuese për ndërmarrjet shënoi ulje. Nivel më të ulët të kredive me probleme deklaruan tri banka, dy prej të cilave me rëndësi sistemike. Kurse,

shtatë banka raportuan pandryshueshmëri sa i përket nivelit të kredive jo-performuese, tri prej të cilave me rëndësi sistematike.

Grafik 3. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuan



Në tremujorin vijues, kërkesa për kredi nga NVM-të pritet të vazhdojë të jetë e lartë, por dukshëm më të ulët krahasuar me atë të raportuar në TM3 2024. Edhe në tremujorin vijues, rritja e kërkesës për kredi pritet të atribuohet kryesisht kërkesës për financim të inventarit dhe kapitalit punës si dhe investimeve fikse.

Gjatë tremujorit të ardhshëm bankat presin që raporti i kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive për ndërmarrjet, të mbetet i pandryshuar, me përjashtim të njëjës bankë e cila ka deklaruar që do të ketë rënie të nivelit të kredive me probleme.


Kreditë ndaj ekonomive familjare

Standardet kreditore

Bazuar në rezultatet e anketës për TM3 2024, standardet kreditore të aplikuar për ekonomitë familjare mbeten të pandryshuara, si për kreditë për blerje të shtëpive edhe për kreditë konsumuese. Pritjet për tremujorin aktual, nga deklarimi i bankave në anketën e kaluar (TM2 2024), rezultuan me shtrëngim të standardeve kreditore, veçanërisht për kreditë konsumuese (grafiku 4). Faktorët me ndikim pozitiv që standardet kreditore të mbeten të pandryshuara përkundër parashikimeve për shtrëngim në anketën e kaluar, ishin perspektiva e mirë në tregun vendor, pozita e likuiditetit të bankave dhe besueshmëria ndaj kredimarrësve.

Në tremujorin e katërt të vitit 2024, standardet kreditore të aplikuar nga bankat pritet të mbeten të pandryshuara nga tremujori aktual, si për kreditë për blerje të shtëpive dhe për kreditë konsumuese. Faktori që pritet të ketë ndikimin negativ në mbajtjen e standardeve kreditore të pandryshuara në tremujorin vijues do të jetë rritja potenciale e kredive jo-performuese, kurse faktorët me ndikim pozitiv pritet të jenë perspektiva e mirë në tregun vendor, pozita e likuiditetit të bankave dhe konkurrenca nga bankat e tjera.


Grafik 4. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan



Kushtet dhe rregullat

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare u lehtësuan deri në një masë për kreditë për blerjen e shtëpive, ndërsa për kreditë konsumuese mbeten të pandryshuara gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024. Konkretisht, rezultatet e gjeneruara nga anketa reflektojnë lehtësim në shumën mesatare për kreditë për blerje të shtëpive, ndërsa kushtet dhe rregullat e tjera mbeten të pandryshuara për të dy segmentet. Sipas deklarimeve të bankave, faktorët që ndikuan në lehtësim të kushteve dhe rregullave për kreditë për blerje të shtëpive ishin konkurrenca nga bankat e tjera, perspektiva e mirë e bankave lokale dhe pozita e likuiditetit të bankave (grafiku 5).

Grafik 5. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ekonomitë familjare



Për tremujorin e katërt të vitit 2024, bankat presin lehtësim të mëtejshëm të kushteve dhe rregullave për kreditë për blerjen e shtëpive, ndërsa për segmentin e kredive konsumuese nuk pritet të ketë ndryshime. Konkretisht, lehtësim pritet të ketë në normën marginale të interesit të aplikuara nga bankat, kurse madhësia e kredisë mesatare, maturiteti dhe kërkesa për kolateral, pritet të mbetet e pandryshueshme. Faktorët që ndikuan në lehtësim të kushteve dhe rregullave për kreditë e reja në tremujorin e aktual, pritet të kenë ndikim në lehtësim edhe në tremujorin e ardhshëm.

Kërkesa për kredi


Bazuar në rezultatet e anketës për TM3 2024, kërkesa kreditore nga ekonomitë familjare në përgjithësi ka shënuar rritje, mirëpo më të ulët në krahasim me tremujorin paraprak (TM2 2024). Rritje deri në një masë të kërkesës për kredi kanë deklaruar kryesisht bankat e vogla dhe vetëm një bankë me rëndësi sistemike. Ndërsa, tri banka të tjera me rëndësi sistemike deklaruan që kërkesa për kredi nga tremujori paraprak ka mbetur e pandryshuar (grafiku 6).

Bankat deklaruan që nevoja për financim të shpenzimeve të konsumit dhe rritja e besueshmërisë konsumatore (perspektiva më optimiste makroekonomike) ka ndikuar në rritjen e lartë të kërkesës për kreditë konsumuese. Ndërkohë, rritja e kërkesës për kreditë për blerje të patundshmërive është ndikuar pozitivisht nga perspektiva e tregut të patundshmërive.

Bazuar në deklarinimin e bankave në anketë, cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ekonomitë familjare mbetet e pandryshuar. Vetëm një bankë me rëndësi sistemike ka deklaruar për rritje të cilësisë së aplikacioneve të pranuar.

Sa i përket cilësisë së portfolios kreditore për ekonomitë familjare, rezultatet e anketës tregojnë përkeqësim deri në një masë të portfolios kreditore, por më u ulët nga tremujori paraprak. Në kuadër të bankave me rëndësi sistemike, vetëm njëra prej tyre ka deklaruar rritje të kredive jo-performuese, ndërsa katër të tjera deklaruan që nuk kishte ndryshim të nivelit të kredive jo-performuese.

Grafik 6. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan



Në tremujorin e fundit të vitit 2024, bankat presin rritje të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, megjithëse në nivel pak më të ulët nga tremujori aktual. Rritje më të theksuar pritet të kenë kreditë konsumuese, si kategoria me peshën kryesore në kuadër të segmentit të ekonomive familjare, ndikuar nga nevoja për financim të shpenzimeve të tjera për konsum dhe nga konfidenca e konsumatorëve. Po ashtu, rritje, por në nivel më të ulët të kërkesës pritet të ketë edhe për kreditë për blerje të shtëpive, mbështetur nga pritshmëritë për perspektivë të mirë në tregun e patundshmërive.


Cilësia e aplikacioneve pritet të përmirësohet deri në një masë, me theks të veçantë për kategorinë e kredive konsumuese.

Për TM4 2024, vetëm një bankë me rëndësi sistemike ka deklaruar që pret përkeqësim në cilësinë e portfolios kreditore të ekonomive familjare, kurse te gjitha bankat e tjera kanë deklaruar që nuk presin ndryshim në cilësinë e portfolios kreditore të ekonomive familjare.

Financimi

Qasja në financim nga bankat gjatë TM3 2024 rezulton të jetë e lartë për dallim nga tremujori paraprak ku bankat deklaruan rënie. Në bazë të rezultateve të anketës, bankat deklaruan rritje të lartë të financimit kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave të ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare (grafiku 7). Sa i përket maturitetit, rritje më të theksuar ka shënuar financimi afatgjatë (mbi një vit) në raport me rritjen e financimit afatshkurtër (më pak se një vit).

Grafik 7. Ndryshimet në financimin e sektorit bankar



Bankat presin rritje me ritëm të lartë edhe për tremujorin e fundit të vitit 2024, ndikuar kryesisht nga rritja e pritur e depozitave nga të dy segmentet, ekonomitë familjare dhe ndërmarrjet. Financimi afatgjatë pritet të shënoj rritje më të theksuar krahasuar me rritjen e financimit afatshkurtër, por në nivel më të ulët nga tremujori aktual (grafiku 7).

Rezultatet e pyetjeve të fokusuar

Për të kuptuar dinamikat kreditore përtej pyetësorit të standardizuar, në TM3 2024 pyetësori i dërguar tek sektori bankar është plotësuar edhe me pyetje shtesë, pyetje që kryesisht kanë mëtuar të zbërthejnë dinamikën e kreditimit të ekonomive familjare – cilësinë e kredive për këtë segment; përqindjen orientuese të kredive për konsum të pambuluara me kolateral; dhe pritjet për dinamikën e kostos së ndërmjetësimit dhe financimit për bankat.

Në anketë, bankat deklaruan se përgjithësisht, **rritja e kredive jo-performuese tek ekonomitë familjare** lidhet kryesisht me kreditë konsumuese dhe klientët në sektorin privat, të cilët janë më të ndjeshëm ndaj pasigurive ekonomike. Sa i përket **përqindjes së kredive për qëllime konsumi në kuadër të kredive të pambuluara me kolateral**, është vënë re një ndryshim i ndjeshëm ndërmjet bankave, duke u luhatur nga nivele shumë të ulëta si 0.2 përqind -1 përqind në disa raste, deri në 50 përqind – 80 përqind në raste të tjera. Kjo varion në bazë të strategjive të bankave, fokusit të kampanjave dhe qëllimeve të disbursimit, me një përqendrim të konsiderueshëm të shpenzimit personale dhe përmirësimi i kushteve të banimit për individët. **Dinamika e kostos së ndërmjetësimit dhe financimit** në periudhën vijuese bankat presin që të ndikohet kryesisht nga normat e interesit në treg, të cilat disa banka presin t'i ulin gradualisht. Ndërsa disa banka presin stabilitet ose ulje të kostove, të tjera përballen me presione nga rritja e normave të interesit dhe konkurrenca, duke ndikuar në marzhet e ndërmjetësimit dhe strategjitë për ruajtjen e likuiditetit.

Përgjigjet e disagreguara të bankave për ndërmarrjet, sipas sektorëve, tregojnë për kahjen e financimit të ekonomisë dhe dinamikat në sektorë të caktuar. Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, standardet kreditore kishin ndryshime marginale të papërfillshme pothuajse në të gjithë sektorët ekonomik (shtrëngime marginale). Përjashtim bëjnë sektori i ndërtimtarisë, ku kishte shtrëngim deri në një masë të standardeve kreditore. Kushtet dhe rregullat u shtrënguan deri në një masë po për sektorin e ndërtimtarisë, ndërsa në sektorët tjerë mbetën pothuajse të pandryshuara. Në anën tjetër, kërkesa për kredi shënoi rritje gjatë kësaj periudhe pothuajse për të gjithë sektorët ekonomik. Sektori me kërkesën më të rritur për financim ishte ai i tregtisë, pasuar nga ai i shërbimeve dhe prodhimit. Kurse, kërkesa për kredi nga sektori i ndërtimit mbeti e pandryshuara gjatë kësaj periudhe.

Bazuar në rezultatet e gjeneruara, gjatë tremujorit të ardhshëm bankat pritet të aplikojnë ndryshime në ofertën kreditore në territorin negativ; shtrëngime marginale për sektorët ekonomikë që nuk janë të ndërlidhur me ndërtim dhe patundshmëri. Kurse, tek këto dy të fundit pritet të ketë shtrëngime

deri në një masë në ofertën kreditore. Kushtet dhe rregullat pritjet të mbesin të pandryshuara me përjashtim të sektorit të ndërtimit, që pritjet të ketë shtrëngime marginale. Në të njëjtën periudhë, kërkesa për kredi pritjet të ketë rritje deri në një masë për sektorin e tregtisë, prodhimit dhe shërbimeve, dhe në nivel më të ulët për atë të ndërtimit dhe patundshmërisë.

Pritjet për Inflacionin

Me qëllim të avancimit të kapaciteteve analitike dhe duke u bazuar në praktikat më të mira rajonale dhe më gjerë, BQK anketon institucionet financiare në vend. Kjo ndodhë duke u mbështetur në hipotezën se institucionet financiare bartin praktikat më të mira nga bankat amë dhe kanë ekspertizën e duhur për të projektuar dinamikat e inflacionit. Nga tremujori i tretë i vitit 2019, AKBK është pasuruar edhe me pyetje shtesë, që adresojnë pritjet e bankave komerciale për zhvillimet e çmimeve në vend. Kjo ndihmon në plotësimin e publikimeve tona në aspektin e analizimit, modelimit dhe parashikimit.

Në pyetësorin e fundit, përveç deklarimit të bankave lidhur me vlerësimet që kanë për nivelin e inflacionit në tremujorin e kaluar, pyetësori adreson edhe pritjet e bankave për tremujorin e katërt të vitit 2024 si dhe për vitin 2024 në përgjithësi. Anketa shërben gjithashtu edhe si një mjet për identifikimin e faktorëve specifik që potencialisht mund të ndikojnë pritjet e bankave për nivelin e caktuar të inflacionit.

Metodologjia

Pritjet e inflacionit luajnë të paktën dy role të rëndësishme. Së pari, ato ofrojnë një statistikë përmbledhëse kuantifikuese për shkallën e inflacionit në të ardhmen, dhe së dyti, mund të përdoren për të vlerësuar besueshmërinë e objektivit të inflacionit të vendosur nga bankat qendrore. Rëndësia e pritjeve të inflacionit është më e madhe për vendet që kanë adoptuar strategjinë e shënjestrimit të inflacionit. Për këto vende, pritjet e inflacionit, shërbejnë gjithashtu si një tregues i besueshmërisë së publikut ndaj bankës qendrore. Nëse publiku beson se banka qendrore do të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të arritur objektivin e inflacionit, atëherë pritjet e agjentëve ekonomik për shkallën e inflacionit do të jenë më të afërta me objektivin e përcaktuar.

Pritjet e inflacionit janë gjithashtu të rëndësishme për bankat që nuk posedojnë politikë monetare, pasi ato shërbejnë si input i rëndësishëm për përcaktimin e çmimeve dhe pagave, si dhe për procesin e modelimit dhe parashikimit ekonomik. Për më tepër, pritjet e inflacionit ndikojnë në kërkesën agregate, e cila më pas ndikon në ecurinë e inflacionit.

Për dallim nga inflacioni aktual, i cili matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pritjet lidhur me inflacionin vlerësohen me metoda të tërthorta. Një prej metodave më të përdorura është anketimi i agjentëve ekonomikë: konsumatorëve, bizneseve, bankave komerciale, etj. BQK, për herë të parë, ka filluar vlerësimin e pritjeve për inflacionin në tremujorin e tretë të vitit 2019, fillimisht me bankat komerciale.

Vlerësimet që merren nga bankat komerciale janë të formës sasiore dhe shoqërohen me shpërndarje të probabilitetit. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore: fillimisht për tremujorin aktual, pastaj për tremujorin e ardhshëm dhe për vitin në përgjithësi. Mbledhja e informacionit përmes anketave pasohet nga procesi i sistemimit, përpunimit dhe agregimit të të dhënave për të gjetur mesataren e pritjeve të inflacionit nga bankat komerciale.

Përmbledhja e rezultateve

Në bazë të anketës së kryer në tetor të vitit 2024, bankat presin që niveli i inflacionit në tremujorin e katërt të vitit 2024 të shënoj një ngritje të lehtë krahasuar tremujorin paraprak. Për gjithë vitin 2024, ato presin që niveli i inflacionit të jetë 2.4 përqind, që tregon një ulje të pritjeve për inflacionin krahasuar me anketën e kaluar, kur bankat prisnin një nivel inflacioni prej 2.7 përqind për vitin 2024.

Tabela 2. Pritja e inflacionit nga bankat, ndryshimi vjetor në përqindje

Bankat	TM3 2024	TM4 2024	2024
1	2.7%	2.8%	2.8%
2	2.4%	2.1%	2.1%
3	2.1%	1.6%	2.1%
4	3.1%	3.1%	3.1%
5	0.2%	2.1%	3.5%
6	1.3%	1.2%	1.7%
7	1.3%	1.7%	2.0%
8	2.4%	0.2%	1.1%
9	2.2%	2.3%	3.1%
10	1.3%	2.4%	2.1%
11	2.4%	2.5%	2.5%
Mesatarja	1.9%	2.0%	2.4%

Burimi: Bankat komercial dhe kalkulumet e BQK-së.


Figura 8 ilustron shpërndarjet e probabilitetit të raportuara nga bankat, duke treguar një siguri relativisht të lartë në lidhje me rezultatin e ardhshëm të inflacionit. Shpërndarja e probabilitetit është e përqendruar rreth inflacionit të pritur, që sugjeron një konsensus të gjerë mes bankave për nivelin e inflacionit të ardhshëm.

Në komentet e tyre cilësore, bankat kanë identifikuar disa faktorë që mund të ndikojnë në një rritje të lehtë të inflacionit në tremujorin e katërt të vitit 2024, siç janë konsumimi i energjisë, ndikimet nga tregjet ndërkombëtare dhe zhvillimet gjeopolitike. Bankat theksojnë se ekonomia e Kosovës mbetet shumë e varur nga importet, duke e bërë inflacionin të ndjeshëm ndaj çmimeve të produkteve dhe shërbimeve që importohen, veçanërisht energjisë dhe materialeve të tjera të cilat janë thelbësore për prodhimin dhe konsumimin vendas. Çdo rritje e çmimeve në tregjet ndërkombëtare ka një ndikim të drejtpërdrejtë në inflacionin e brendshëm.

Po ashtu, bankat theksojnë ndikimin e mundshëm të shpenzimeve të diasporës dhe shpenzimeve publike, të cilat mund të nxisin konsumin dhe të çojnë në rritje të çmimeve. Në aspektin e politikës monetare, ulja e normave të interesit nga Banka Qendrore Europiane mund të nxisë rritjen e inflacionit përmes rritjes së huamarrjes dhe konsumit, duke shtuar kështu kërkesën në ekonomi.

Si përfundim, të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës deri në nëntor të vitit 2024 tregojnë ngadalësim të inflacionit, me normë mesatare prej 1.7 përqind. Edhe pse pritjet e bankave mund të ndikohen nga zhvillimet globale dhe pasiguria që lidhet me to, ato mbeten relativisht të larta, duke pasur parasysh trendin aktual të inflacionit, i cili është më i ulët se sa pritjet e bankave.

Grafik 8. Probabiliteti i inflacionit për TM4 2024 (boshti-x: pritjet e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje; boshti-y: probabiliteti)



Burimi: Bankat komerciale dhe kalkulumet e BQK-së.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org